

DELET DHE QINGJAT

Informacione Profesionale të Përgjithshme

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe

Aksioner i AUSTRIA Prämix shpk.



Qingjat

Për rritjen e qingjave për remont ose për majmëri, ushqimi mineral është i lidhur me pritshmëritë e mëposhtme:

- Zhvillim në ripërtpës të denjë (nëpërmjet konsumimit të koncentreve dhe ushqimit voluminoz)
- Shmangia e simptomave klinike.
- Shfrytëzim i potencialeve gjenetike.
- Forcimi i sistemit imunitar.
- Shkurtim i periudhës së majmërisë.
- Ndërzim i hershëm.
- Ulja e shkallës së humbjeve.
- Shëndet i mire i kockave.
- Konvertimi optimal.

Me MILLAPHOS është e mundur të arrihen nivelet maksimale!

Qingjat femra

Pesha (kg)	Shtimi ditor në peshë (g)	Konsumi i lëndës së thatë (kg)	Lëndë ushqyese nXP (g) MJ ME	Lëndë minerale (g) Ca / P / Na / Mg
20	200 300	1,0	125 9,8 155 12,4	10,0 / 4,0 / 1,0 / 1,0
30	200 300	1,3	160 13,0 200 16,4	11,0 / 4,5 / 1,0 / 1,0
40	200 300	1,5	200 16,1 250 20,8	12,0 / 5,0 / 1,5 / 1,0

Qingjat meshkuj

Pesha (kg)	Shtimi ditor në peshë (g)	Konsumi i lëndës së thatë (kg)	Lëndë ushqyese nXP (g) MJ ME	Lëndë minerale (g) Ca / P / Na / Mg
20	300 400	1,0	140 11,4 170 13,8	10,0 / 4,0 / 1,0 / 1,0
30	300 400	1,3	180 14,7 215 17,6	11,0 / 4,5 / 1,0 / 1,0
40	300 400	1,5	220 17,8 265 21,4	12,0 / 5,0 / 1,5 / 1,0
50	200 300	1,6	210 17,0 255 20,6	13,0 / 5,5 / 1,5 / 1,0

Nevoja për mikroelementë dhe vitamina

Mikroelementë:

Për çdo kilogram masë të thatë

- 50 mg hekur
- 8 mg bakër
- 60 mg mangan
- 30 mg zink
- 0,08 mg kobalt
- 0,2 mg jod
- 0,15 mg selen

Vitamina:

Për çdo 10 kilogram masë trupore dhe ditë

- 1,000 I.E Vitamin A
- 150 I.E. Vitamin D
- 5 mg Vitamin E
- 1 mg Vitamin B1
- 1 mg Vitamin B2
- 1 mg Vitamin B6
- 6 mg Vitamin B12
- 8 mg Niacin
- 4 mg acid pantotenik

Objektivat e të ushqyerit

Nëpërmjet furnizimit optimal me lëndë minerale, oligoelementë dhe vitamina, arrihen qëllimet e mëposhtme:

- Shmangen simptomat klinike të mungesës së lëndëve minerale.
- Shfrytëzohet në maksimum gjenetika.
- Përmirësim i pjellorisë:
 - Shtim në peshë
 - Më pak aborte spontane
 - Rritje e mundësisë së pjelljes së binjakëve

- Qingja vital
- Rendiment i lartë qumështi
- Forcim i sistemit imunitar
- Kohë më e gjatë shfrytëzimi

Furnizimi me kalcium dhe fosfor

Kalciumi është një element mjaft i rëndësishëm për formimin e kockave. Përveç kësaj, kalciumi është i nevojshëm për koagulimin e gjakut, funksionin e muskujve dhe të sistemit nervor. Mangësitë e furnizimit me kalcium tek kafshët e rritura, mund të shkaktojnë probleme me kockat (osteoporozë). Tek kafshët e reja, kockat mbeten të buta dhe të deformuara.

Për këtë arsye, duhet bërë kujdes me raportin kalcium fosfor (Ca:P) në ushqimin e deleve dhe dhive. Të gjitha mineralet e marra me tepricë, duhet të eskretohen nga veshkat. Sasi të larta të kalciumit dhe të drithërave, shkaktojnë formimin e gurëve dhe bllokimin e uretës në formë S-je. Raport shumë i ngushtë Ca:P me tepricë fosfori, mund të çojë në mangësi të furnizimit me kalcium.

Çrregullime të bilancit të fosforit, kanë ndikim negativ mbi pjellorinë. Meqënëse një furnizim i pamjaftueshëm me fosfor çon në depresion prodhimitar, përpara përdorimit të premiksit duhet të verifikohet nëse racioni ushqimor është i mirëbalancuar.

Vitaminat në rritjen e deleve dhe dhive

Vitaminat A, D dhe E janë të rëndësishme për ushqyerjen e deleve dhe dhive.

Vitamina A është shumë e rëndësishme për rritjen e kockave dhe lëkurës. Mungesa e saj shkakton hornifikim, të cilat shfaqen si në lëkurën e jashtme të trupit ashtu edhe në mukozat e brendshme të sistemit të frymëmarrjes, të sistemit tretës, sistemit riprodhues dhe mukozën e syrit. Në këtë mënyrë, lehtësohet depërtimi i mikrobeve patogjenë dhe zvogëlohet rezistenca e kafshës. Si pasojë e ndryshimeve në mukozën e organeve gjenitale, femrat kanë ndikim negativ në procesin e fekondimit. Gjatë procesit të fekondimit, embrioni ushqehet dobët, gjë që çon në deformime dhe dështime. Përveç kësaj, vitamina A është e nevojshme edhe për metabolizmin e organeve riprodhuese. Tek kafshët meshkuj, ndikon në formimin e spermës dhe cilësisë së saj.

Mangësitë e vitaminës A shkaktojnë osteomalaci (rakitizëm), sidomos te kafshët në rritje, sensibilitet ndaj frakturave, gjakderdhje në indet e trupit dhe degradim të lëkurës dhe mishit të dhëmbëve.

Vitamina D formohet në lëkurë nga efekti i rrezeve diellore UV, ndikuar nga kushtet dritë-errësirë. Kjo vitaminë është esenciale për formimin e kockave dhe fortësinë e thundrave. Një furnizim i mirë me vitaminë D, çon në një përmirësim të ardhjes në afsh dhe në përqindje të larte të barsmërisë. Mangësi të vitaminës D mund të shkaktohen nga stalla të pandriçuar mirë.

Vitamina E është e rëndësishme për metabolizmin e qelizave. Ajo siguron mbrojtje aktive të qelizave dhe mbrojtje kundër infeksioneve. Është e rëndësishme për pjellorinë dhe formimin e antitropave.

Në ushqimin e deleve dhe të dhive duhet të përdoret premikse pa përmbajtje bakri, por megjithatë delet dhe dhitë në laktacion, kanë kërkesë të përditshme për bakër. Duke marrë parasysh që kafshët e imta në periudhën e laktacionit kanë nevojë për një sasi të caktuar bakri nga 15 deri në 30 g për çdo kafshë në laktacion. Prandaj duhet të sigurohet një furnizim i saktë me ushqim. Rreziku i përdorimit të premiksit të gjedhit është në dorë të çdo fermeri. Qingjat duhet të mbahen të ndara dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të konsumojnë nga ky ushqim sepse ekziston rrezik për helmim.

Sipas programit të SHAUMANN për ripërthypësit:

Nga gama e produkteve për gjedhin, rekomandohen për përdorimin e të imtave, produktet si Rindavit Start me përmbajtje bakri 220mg/kg dhe Kalvicin Pro me 280 mg /Kg nga produktet e Schaumann

Rëndësia e pjellorisë në rritjen e deleve dhe ndikimi i ushqimit dhe higjenës.

Përgatitjet paraprake për periudhën e ndërzimit ofron premisa optimale për një pjellje sa më të lehtë

Ndikimi mbizotërues i performancës së pjellorisë së deleve mbi përfitimet e fermave me dele bëhet e dukshme sepse diferenca e të ardhurave ndërmjet racave pjellore me numër produktiviteti 172 dhe racave me numër produktiviteti relativisht të ulët 122, është rreth 15.000 € të ardhura për fuqi pune në vit.

Në rritjen e dhenve në Gjermani synohet një numër mesatar produktiviteti prej 130 në të gjitha fermat. Kjo do të thotë 1,3 qingja të rritur për dele.

Sipas „Schlolaout“ mund të supozohet se mesatarja e klasifikimit gjenetik e racave në Gjermani duhet të jetë 1.8 qingja për pjellje. Për racat më pjellore, kjo vlerë është 2,4 qingja për pjellje. Si masë mbështetëse për shfrytëzimin e potencialeve gjenetike është njohja e kohës biologjike optimale të pjelljes dhe të ushqyerit me faza i deleve. Furnizimi i mjaftueshëm i dhenve me ushqim mineral MILLAPHOS Z është në këtë rast i një rëndësie të veçantë.

Sidomos në fund të verës para ndërzimit, kur kullotat nuk janë shumë të pasura me ushqim, rritet nevoja për ofrimin e rregullt të ushqimit mineral. Delet janë më të dobta nga laktacioni i

mëparshëm dhe duhet të plotësojnë përsëri rezervat. Vetëm një organizëm i mirëfurnizuar mund të krijojë kushtet për një fekondim të mirë dhe një mbarsje pa probleme.

Furnizimi me ushqim mineral MILLAPHOS Z nuk do të ketë probleme në tufat me sistemin automatik të furnizimit RINDAMAT. Masat „të ushqerit-Flushing-“ (pak para ndërzimit në kullota ose koncentrat) mbështeten nga furnizimi me ushqim mineral.

Përveç rritjes së normave të pjelljeve duhet t'i kushtohet vëmendje edhe rritjes së numrit të produktivitetit në interes të përmirësimit të të ardhurave të rritjes së dhene sidomos reduktimit të humbjeve të rritjes së qingjave.

Masat e lidhura me higjenën dhe luftimi i prazitëve të brëndshëm të rregullt kanë në rritjen e qingjave ndikim të madh në uljen e humbjeve.

Për qingjat e shëndetshëm duhet furnizim intensiv. Shtimi ditor në peshë rritet në mënyrë të konsiderueshme nëse i ofrohet përveç qumështit dhe ushqimit voluminoz edhe koncentrat.


Vitaliteti i lartë dhe shanset për mbijetesë të lidhura me rritjen e vrullshme të qingjave janë të garantuara kur ushqimi i rritjes përbëhet nga 76% misër, 20 % Bersi soje dhe 4% MILLAPHOS L.

Minerali dhe koncentrat i aktiv MILLAPHOS L përfshin hulumtimet e reja të Hülsenberg. MILLAPHOS L rrit vitalitetin dhe cilësinë e mishit të qingjave në mënyrë ideale.

Nevoja për energji dhe minerale – Dele

Këshilla në gramë për kafshë dhe ditë

Delet	Ca	P	Na	Mg
Përmbajtja	7,5	5,5	1,5	1
Deri në ditën e 90-të të mbarsjes	8,5 15	6 7,5	2 2	1 1,5
Në laktacion, 1 qingj	17	9	2	2,5
Në laktacion, 2 qingja	20	10	2,5	3



Kërkesa për mikroelement dhe vitamina – Delet

Mikroelement:

Për çdo kilogramë lëndë të thatë:

- 50 mg hekur
- 8 mg bakër
- 60 mg mangan
- 40 mg zink
- 0,08 mg kobalt
- 0,3 mg jod
- 0,15 mg selen


Vitamina:

Për kafshë dhe ditë:

- 2.000 – 6.000 I.E: Vitamin A
- 200 – 600 I.E: Vitamin D
- 50 -100 mg Vitamin E

Të gjitha vitaminat e tjera mund të absorbohen gjatë sintezës mikrobiale në rumen, kjo do të thotë që furnizimi i poshtshëm nga jashtë nuk është i nevojshëm.

Pesha e uterusit dhe fetusit:



Barrëse rëndë					
Fetus	Pesha/fetusi	MJ ME	g XP	g Ca	g P
1	3 kg	13	125	9,0	6,0
	5 kg	15	155	9,0	6,0
2	3 kg	15	130	9,0	6,0
	5 kg	19	190	9,0	6,0

Laktacion					
	Kg qumësht/ditë	MJ ME	g XP	g Ca	g P
	1	18	225	10,3	6,0
	2	26	365	15,7	7,7
	3	34	505	24,0	9,6

	4	42	645	26,5	11,4
--	---	----	-----	------	------